548
14.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

R E L A C I O N

KËSHILLIT BASHKIAK

MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026 NGA GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË, TRASHËGUAR NGA VITI 2025, MIRATUAR ME VKB NR.122 DATË.23.12.2025

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të shkresës nr. 18133/1, datë 24.12.2025, ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Grant i Performancës për bashkitë", si dhe udhezimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për pushtetin Vendor nr. 1031/5, datë 11.07.2025, dhe nr. 10725, datë 11.07.2025, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Granitit të Bazuar në Përformancë për bashkitë për vitin 2025", si dhe në vijim të shkresës së Agjensisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 port., datë 19.12.2025, e cila përcjell vendimin e Komisiont të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, Ligjit nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", është akorduar Fondi i Grantit të Bazuar në Performancë për vitin 2025 sipas bashkive, me burim financimi buxhetin e shtetit me vlerë totale 6,833,896,62 lekë nga të cilat 3,056,179.78 lekë janë me financim nga buxheti e shtetit dhe 3,777,716.84 lekë jane me burim financimi të huaj.
Për Grantin e Bazuar në Performance me burim financimi të huaj, shtesa e fondit do të kryhet në momentin e marrjes së vendimeve nga keshillat bashkiake për destinacionin e përdorimit të tij, në përputhje me përcaktimet e pikës 11.B të Udhëzimit të specifikuar më lartë.
Bashkitë kanë pavarësi të plotë në përcaktimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblimet.
Duke qenë se mbledhja e Këshillit Bashkiak u zhvillua në datë 23.12.2025 përpara ardhjes së shkresës nga Ministria e Financave me nr 18133/1 prot datë 24.12.2025 e ardhur në institucionit tonë me nr 11505 prot datë 30.12.2025, për pasojë nuk ishte e mundur që të paraqitej materiali për mbledhje shtesë të Këshillit Bashkiak për të shpërndarë fondet brenda vitit 2025, fondet në fjalë (fondet me financim nga buxheti e shtetit) trashëgohen dhe programohen për buxhetin e vitit 2026.
Gjatë mbledhjes së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) u diskutua mbi destinacionin e përdorimit të kësaj transferte, në përputhje me përcaktimet e Ministrisë së Financave, dhe u vendos që fondi të përdoret për financimin e një projekti të ri investimi me objekt

"Sistemim i dy shesheve të pallateve përgjatë rrugës 'Besim Nuri' në Lagjjen 'Kongresi i Lushnjes'" në vlerën 6,833,896,62 lekë.

1. **Të rriten të ardhurat e Bashkise Lushnje për buxhetin e vitin 2026 për vlerë totale 6,833,896,62 lekë (kapitull 01+ kapitull 02)**

   a) Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2026 për vlerën 3,056,179.78 lekë (kapitull 01)
   b) Të rriten të ardhurat në buxhetit për vitin 2026 nga Grantiti Bazuar në Performancë për vlerën 3,777,716.84 lekë. (kapitull 02) pasi të miratohet në Këshillin Bashkiak për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të këtij fondi

2. **Të rriten shpenzimet për vitin 2026 për vlerën 6,833,896,62 lekë (kapitull 01+ kapitull 02)**

   a) Të rriten shpenzimet për vitin 2026 për vlerën 3,056,179.78 lekë që janë alokuar në Degën e Thesarit me kaplitull 01
   b) Të rriten shpenzimet për vitin 2026 për vlerën 3,777,716.84 lekë që priten të alokohen në Degen e Thesarit me kapitull 02, pasi të miratohet në Këshillin Bashkiak për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të këtij fondi.

Rritja do të shkojë në:
Në Bashkinë Lushnje në programin AB129 "Shërbimet Publike Komunitare" 3,056,179.78 lekë investime (AB129-01-231) dhe 3,777,716.84 lekë investime (AB129-02-231) (kodi do të celet nga Ministria e Financave)
Kodi i produktit/projektit do të jetë i njëjtë për të dy burimet e financimit si për buxhetin e shtetit ashtu edhe për financimin e huaj.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Juljana Hasalla

Drejtoria Financë –Buxhetit

Ervisa Çuko

KRYETAR I BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 548/1 **Prot.** **Lushnje, më** 14/01 **/2026**

PROJEKT-VENDIM Nr. 13
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2026
NGA GRANTI I BAZUAR NË PERFORMANCË, TRASHËGUAR NGA VITI 2025
(Miratuar me VKB nr.122 datë 23.12.2025)

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____ 2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "**Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2026",** mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 gërma dh, në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 103 të ndryshuar, ligjit nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", në mbështetje të Udhezimit të Përbashkët nr 1, datë 11.07.2025 "Për kriteret, procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025,

PROPOZOJMË:

1.Të rriten të ardhurat e buxhetit për vitin 2026 për vlerën **6,833,896,62 lekë.**.

a. 3,056,179.78 lekë, (00-01-AB129-231) (burimi i financimit nga buxheti i shtetit alokuar në Degen e Thesarit)
b. 3,777,716.84 lekë, (00-02-AB129-231) (burimi i financimit i huaj, alokimi do të kryhet pas miratimit të vendimit nga Këshilli Bashkiak)

2. Të rriten shpenzimet për vitin 2026 për vlerën **6,833,896,62 lekë.**.

Rritja do të shkojë në:

a. Në **Bashkine Lushnje**, në programin AB129 "Shërbimet Publike Komunitare për 3,056,179.78 lekë, (00-01-AB129-231) (burimi i financimit nga buxheti i shtetit alokuar në Degen e Thesarit)

b. Në **Bashkine Lushnje**, në programin AB129 "Shërbimet Publike Komunitare për 3,777,716.84 lekë, (00-02-AB129-231) (burimi i financimit i huaj, alokimi do të kryhet pas miratimit të vendimit nga Këshilli Bashkiak)
Kodi i produktit/projektit do të jetë i njëjtë për të dy burimet e financimit si për buxhetin e shtetit ashtu edhe për financimin e huaj.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financë-Buxhetit, Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Juljana Hasalla

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Drejtoria Financë –Buxhetit

Ervisa Çuko

KRYETAR I BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE